

DRAFTI I
RAPORTIT TE VLERESIMIT TE
NDIKIMIT NE MJEDIS
TE AKTIVITETIT

"Thertore dhe rritje intensive e derrave dhe
vicave"



Subjekti : AB-GERSA shpk
Hartoi: "EKO-STUDIO-PROJEKT" sh.p.k
Administrator : Shkelzen MADANI



Tirane 2019

PERMBAJTJA

- ✚ Hyrje
- ✚ Baza ligjore
- ✚ Metodika e vleresimit te mjedisit
- ✚ Objektivat dhe qellimi i VNM-se

1. PERSHKRIMI I AKTIVITETIT

2. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

5. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

HYRJE

Aktiviteti njerezor qe zhvillohet ne çdo aspekt te vetin, perveç dobesive ne menyre te pashmangshme krijon dhe “produkte” qe ne perfundim mund te sjellin probleme per zhvillimin e qendrueshem te mjedisit. Pavaresisht nga vlerat dhe volumet edhe ne Shqiperi keto probleme vrojtohen dhe shoqeria e shteti kane synuar dhe vazhdojne te organizojne dhe orientojne kete proces. Ndotja e mjedisit nenkupton shkarkimet e cdo lloj mbetje nga pjese te materialeve te ndryshme ne uje , toke, ajer e cila shkakton ose mund te shkaktoje probleme mjedisore te perkoheshme ose te perhershme ne balancen ekologjike te tokes. Se bashku me zhvillimin e madh qe eshte bere ne industri te ndryshme ne menyre te ngjashme me te njejten shpejtesi eshte rritur edhe sasia e mbetjeve nga perdorimi i te mirave materiale. Mbetjet industriale dhe ato urbane te patrajtuara , emetimet e gazeve te demshem ne atmosfere, perdorimi i kimikateve te reja pa marre parasysh demet qe mund ti sjellin mjedisit kane sjelle problemet mjedisore me te cilat ne perballemi ne ditet e sotme.

Materiali qe paraqitet trajton ndikimet ne mjedisin fizik dhe human te aktivitetit:

"Thertore dhe rritje intensive e derrave dhe vicave"

BAZA LIGJORE

Relacioni u pergatit ne zbatim te akteve ligjore dhe nenligjore Mjedisore :

- *Ligji Nr.10 431, date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”*
- *Ligji nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »*
- *Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »*
- *Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”*
- *Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”*
- *Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”*
- *Ligji nr. 10 266 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”*
- *Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”*
- *Vendim nr.805 date 4.12.2003 « Per miratimin e listes se veprimtarive qe ndikojne ne mjedis per te cilat kerkohet leje mjedisore »*
- *Ligj nr. 8094 date 21.03.1996 « Per largimin publik te mbeturinave »*
- *Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »*
- *Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’*
- *VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subjekt te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mejdisit si dhe rregullave te hollesishme per shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKL-ja ».*

- *Vendim Nr.13, date 04.01.2013 ” Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis”.*

➤ **Pershkrimi i metodikes se zbatuar per hartimin e raportit te VNM-se**

Hartimi i raportit te VNM-se behet me qellim qe te merren parasysh dhe te analizohen te gjitha faktoret kryesore dhe dytesore qe ndikojne ne mjedis gjate zhvillimit te aktivitetit. Ky raport gjithashtu ka si qellim te jape nje pasqyre te pergjithshme mbi efektet negative e pozitive ne mjedis, alternativat e mundshme dhe masat zbutese te efekteve te padeshirueshme.

Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis eshte nje studim qe synon parashikimin e te gjitha efekteve te pritshme ne mjedis, qe do te rezultojne nga projekti i propozuar, si gjate zbatimit te tij dhe gjate funksionimit.

➤ **Profili i propozuesit**

Subjekti: ” AB-GERSA” shpk ,eshte regjistruar ne QKB me nr NIPT : K538234011,ne date 10/02/2005 subjekt do te ushtroj aktivitetin e "Thertore dhe rritje intensive e derrave dhe vicave"

duke mbajtur kafshet per nje kohe te shkurter ne 2 stallat te cilat i ka ne dispozicion per kete aktivitet .Me pergatitjen e dokumentacionit perkates subjekti kerkon te pajiset me Leje Mjedisore tipi B referuar ligjit 60/2014 date 19.06.2014, per nje ndryshim ne ligjin 10 448 per Lejet e Mjedisit.



Pershkrimi i projektit

Kompleksi eshte i pajisur me stalla per mbajtjen e derrave dhe vicave per mbareshtimin e tyre si dhe ambientet e thertores.

Teknologjia

Kjo teknologji eshte bashkimi i te gjitha metodave shkencore te punes, te karakterit zooteknik, veterinar, ekonomik, inxhinierik dhe elektronik, te lidhura keto ngushtesisht dhe qe bejne te mundur shtimin e prodhimit te mishit te derrit, me cilesi te mire dhe rentabilitet. Kryesore ketu eshte qe te shfrytezohet sa me mire vecorite gjenetike te derrave.

Kjo ndertohet nga keto hallka:

- Permiresimi rracor
- Menyrat e te ushqyerit
- Procesi i therjes

Permiresimi rracor

Ne kompleks punohet me keto rraca: e bardha e madhe dhe landras hollandez, ndersa per harcat meqenese do te perdoren kryqezime industriale apo edhe hibridizime, kerkohet qe vec dy rracave kryesore edhe harca te rracas Durok ose Pietren. Ne kompleks mbareshtrohet Pullaliu amerikan.

- Keto rraca pershtaten lehte me kushtet klimatike dhe ushqimet e ndryshme, prodhojne mish me pak dhjam.

Menyra e te ushqyerit

Derri kerkon ushqim me tretshmeri shume te larte dhe te balancuar ne te gjitha lendet ushqimore. Nuk pelqen ushqimet e ashpra dhe nuk i tret ato me permbajtje celuloze. Tek derrat mbizoteron tretja fermentike. Per kete duhet qe ushqimi kokerr te bluhet imet. Derri ha cdo gje por jo cdo gje qe ha e tret. Aparati tretes nuk ka aftesi te sintetizojte proteina me vlere te larta biologjike prandaj ato sigurohen gjate racionit ushqimor.

Procesi i therjes

Procesi teknologjik i therjes realizohet ne ambientin e caktuar nga shoqeria e cila eshte e kompletuar me makineri dhe pajisje.

Procesi i therjes fillon me pranimin e derrave ne thertore e me pas me pushimin para therjes. Mbas pranimit kafshet qendrojnë për tu çlodhur dhe i nënshtrohen nje procesi gjate te cilit ato nuk duhen ushqyer. Koha e qendrimit te kafsheve ne fabrike, para therjes, eshte maksimumi tre dite. Bagëtisë në periudhën e urisë i ndërpritet ushqimi dhe i jepet ujë, i cili ndërpritet 2-3 orë para therjes. Pushimi dhe periudha ne te cilen ato lihen pa ngrene bëhet për shumë arsye teknologjike: shmangien e mundimit fizik dhe ngacmimeve nervore që ndikojnë në procesin e çgjakësimit, zvogëlimin e përmbajtjes së ushqimit në aparatit tretës gjë që ndikon në uljen e ngarkesës mikrobiale, lehtëson proceset e mëtejshme të therjes si heqja e lëkurës, nxjerrja e organeve të brendshme etj.

Pas qëndrimit në dhomën e para therjes, derrat merren dhe shpërlahen për të ulur ngarkesën mikrobiale dhe më pas kryhet trullosja me qëllim uljen e rezistencës së kafshëve gjatë therjes, pra që këto të fundit të mos reagojnë dhunshëm. Gjatë trullosjes nuk duhet që kafsha të humb funksionin e zemrës dhe organeve të frymëmarrjes pasi pengohet procesi i çgjakësimit duke bërë që të ulet cilësia e mishit.

Trullosja kryhet me këto mënyra: trullosje mekanike konsiston në goditjen e derrave me mjete të forta në rajonin ospital të kafkës së kafshës. Mjeti më i përshtatshëm që përdoret është

vareja, një çekiç i rëndë prej dy kilesh në formë konike dhe me gjatësi bishti rreth një metër. Mbas trullësjes kryhet çgjakësimi, ky proces kryhet duke bërë prerjen e venës dhe atë të arteries karotis.

Qëllimi i çgjakësimit është largimi i gjakut, pasi qëndrimi i tij në mish bëhet burim prishjeje, pasi dihet që gjaku është një mjedis shumë i përshtatshëm për mikroorganizmat. Çgjakësimi bëhet në pozicionin vertikal sepse arrihet një shkallë çgjakësimi më e mirë. Kjo realizohet për një minutazh të caktuar. Mbajtja për një kohë më të gjatë do të shkaktojte largimin e një sasive të lartë gjaku, i cili do të sillte si pasojë çngjyrimin e mishit duke ulur intensitetin e ngjyrës.



Mbas çgjakësimit bëhet heqja e kokës dhe heqja e lëkurës ajo bëhet kryesisht me dorë por edhe e mekanizuar. Më pas vjen kontrolli veterinar, ky konsiston në kontrollin e mishit të derrave të cilat mund të jenë të prekura nga sëmundje të ndryshme si të mëlçisë, zemrës mushkërive dhe vetë mishit. Mishi kontrollohet edhe për "abscese" dhe në rastet e ndodhjes së tyre largohet ajo pjesë e kontaminuar.

Po ashtu kur mishi gjatë kontrollit del se është i prekur nga sëmundje veçohet dhe sipas vlerësimit të mjekut dërgohet për trajtime të mëvonshme të veçanta.

Pas kontrollit veterinar mishi vulozet nga mjeku veterinar dhe vlerësohet nga teknologu cilësia e mishit, lloji i tij sipas standardit në fuqi dhe i jepet destinacioni i duhur. Trupave të therur u bëhet edhe tualeti i cili është dy llojesh i njomë dhe i thatë. Tualeti i thatë konsiston në largimin e dhjamërave të barkut, pjesëve të gjakosura, gjëndrave të papërdorshme si ushqim, absceset, mbeturinat e mishit të diafragmës, mbetje të trakesë dhe të ezofagut etj. Tualeti i njomë bëhet gjithmonë mbrapa atij të thatë, ai kryhet me anë të dushit ku mishi lahet me ujë të freskët dhe të ftohtë me qëllim që të largohen të gjitha papastërtitë dhe gjakrat në sipërfaqe. Tualeti i njomë gjithashtu ka për qëllim uljen e temperaturës së mishit të porsatherur. Duhet pasur kujdes që mbas tualetit të njomë të bëhet tharja me leckë të thatë ose me ventilim sepse lagështia që ngelet rrezikon prishjen e mishit.

Në ambientet e subjektit theren rreth 10-15 bageti njekohesisht. Gjaku mblidhet në një depozitë të përgjithshme. Pasi lahet kjo depozitë, masa ujore kalon në impiantin që është i përbërë nga 3 dhoma e në këtë impiant ndodh pasurimi i ujit me oksigjen. Ndahen pjeset e ngurta nga lengu. Me pas kemi dy pompa që i kalojnë në dy dhomat e tjera e ku ndodh shtimi i oksigjenit. Pasi rritet niveli i oksigjenit dhe dendësitë e ngurta precipitojnë. Pas kësaj uji i pasuruar me oksigjen kalon në lume.

Subjekti "Ab-Gersa" sh.p.k bën një riciklim të mbetjeve që vijnë nga kafshet që theren në thertoren. Të gjitha mbetjet e këtyre gjallesave përdoren si pleh organik, në aktivitete të tjera bujqesore që subjekti ka në zotërim.

1. PERSHKRIMI I RAJONIT KU DO ZHVILLOHET AKTIVITETI

Gjeologjia e rajonit

Ne kete rajon kemi te bejm me tokat e hirta e te kafta , keto toka jane formuar mbi shkembinj argjilor te neogjenit. Kane profile te diferencuara me ngjyre te hirte te kuqerremte, perberje mekanike subargjilore te mesme ne te rende. Perberja kimike e tyre tregon se jane mestarisht te pasura me humus. Persa i perket elementeve ushqyes te asimilueshme nga bimet keto toka paraqiten te varfera me azot dhe fosfor dhe te pasura ne patos. Kuota ku eshte ngritur ky aktivitet eshte me nje ngritje te vogel nga toke bujqesore e cila lejon qe te kemi vetrrjedhje te ujervae te bardha dhe te reshjeve. Nga ana gjeologjike ne bazamentin ne bazamentin ku eshte ndertuar ky aktivitet ka te bej me formacionin kuaternar Q₄AL. Formacioni argjilor nuk lejon qe ujerat siperfaqesore te reshjeve si dhe uejrat e ndotura te futen ne thellesi, por ato per shkak te kuotes se larte dhe kanaleve kullues drejtohen drejt kanalit kryesor ku para se te shkojne ne kuoten me te ulet ka nje grope dekantimi.

Klima

Fieri ashtu si e gjithë Shqipëria bën pjesë në brezin e klimës mesdhetare, dhe dallohet për tipare më të shprehura mesdhetare, e cila karakterizohet nga vera e nxehtë dhe e thatë me shkëlqim të madh të diellit dhe dimër i butë dhe me rreshje të mëdha. Ngricat dhe dëborat janë dukuri tepër të rralla. I nxehti fillon që prej mesit të pranverës dhe vazhdon deri në fund të tetorit. Klima e Fierit është e ngrohtë sepse Fieri laget nga deti dhe është i mbrojtur nga lindja prej erërave të ftohta. Fieri dallohet për numerin e lartë të ditëve me diell, mesatarisht 2800 ore në vit. Rreshjet kanë rregjim kohor shumë të çrregullt ato janë përqendruar kryesisht në gjysmën e ftohtë të vitit, sasia mesatare e tyre arrin 980-1000 mm/vit. Vera në Fier është e thatë dhe shpesh nuk bie shi për javë të tëra. Muajt më të lagesht janë nëntori dhe janari, kurse muajt më të thatë korriku dhe gushti. Erërat fryjnë në drejtime të ndryshme por gjatë dimrit mbizotëron era e jugut, e cila sjell edhe rreshje të mëdha, ndërsa gjatë verës era fryn nga veriu dhe veriperëndimi. Afërsia me detin bën që klima të jetë e butë dhe vetëm në raste tepër të rralla temperaturat të bien nën zero. Temperatura mesatare vjetore lëkundet nga 15°C-16°C. Klima e Fierit lejon zhvillimin e një bujqësie shumë degëshe. Gjithashtu tokat bujqësore mund të shfrytëzohen 2-3 herë në vit. Zona ku do zhvillohet aktiviteti ka klimë mesdhetare fushore. Temperatura mesatare më e larte eshte ne muajin korrik, gusht 23 °C, dhe me e uleta ne muajin Janar 7.2 °C. Ndryshimi i lageshtise relative te ajrit gjate vitit eshte i lidhur ngushte me ecurine e temperatures se ajrit. Vlerat me te larta te lageshtise jane ne periudhen e ftohte te vitit ndersa

me te uleta ne periudhen e ngrohte te tij. Per arsye se jemi prane zones fushore dhe ne afersi te detit mbizoterojne erera nga kuadrati i perendimit dhe veri perendimit. Ne dimer mbizoterojne erera te lindjes dhe te jugut.

Trashegimia arkitektonike

Aktiviteti qe kryhet nuk prek zonat turistike, zona te mbrojtura, zona arkeologjike, arkitektonike, objekte te trashiguara dhe te ndertuara nga njeriu me rendesi historike, sepse ne kete zone ato nuk ekzistojne. Eshte per t'u theksuar se ne kete zone nuk ka monumente kulture, zona arkeologjike dhe gjeomonumente.

Flora dhe fauna

Bota natyrore bimore dhe shtazore e rrethit është transformuar nga veprimtaria e njeriut. Megjithatë zona dallohet për disa lloje bimesh e kafshesh sidomos ne pjeset bregdetare e fushore. Takohen disa lloje kafshesh si urithi, cakalli, nusja e lales, dhelpra, shkurteza, mellenja, thelleza e fushes si dhe disa lloje te ndryshëm zvarranikesh e gjarprinjs. Ndërsa ne ujerat e detit gjenden shumë lloje peshqish si qefulli, levreku, koca etj. Zona bën pjese ne brezin e shkurreve dhe te pyjeve mesdhetare. Shkurret perbehen nga nenkati I makies, ku rriten shkurret me gjelberim te perhershem si mareja, shqopa, gjineshtra, dafina. Ne këtë nenkat bimor rriten edhe disa drure te lartë si selvia, valanidhi, pisha e bute dhe e eger, qe ne disa raste formojne pyje te vegjel

Pasurite ujore

Ne kuadrin e pasurive natyrore rëndësi të veçantë kanë pasuritë ujore, ku përveç detit Adriatik, rrethi përshkohet nga lumenjtë Seman, Vjosë e Gjanica. Semani - 281 km i gjatë formohet nga bashkimi i Devollit me Osumin në afërsi të Beratit. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 5949 km², prurja mesatare vjetore e tij arrin në 96 m³/sek. Semani është ndër lumenjtë më eroziv, duke e bërë lumin me eroziv në vend. Vjosa - 272 km i gjatë buron nga malet e Pindit në Greqi. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 6700 km², ndërsa prurja mesatare vjetore e tij arrin 195 m³/sek. Gjanica - 67 km buron nga burimet e Poçemit e të Kalivaçit. Siperfaqja e pellgut ujëmbledhës është 234 km². Është një nga lumenjtë më të ndotur në vend, për shkak të derdhjes së naftës. Rrethi ka edhe disa liqene artificiale ku më i madhi e më i rëndësishmi prej tyre është ai i Kurjanit me sipërfaqe 375 ha, ujërat e tij përdoren për ujitje.

3. VLERESIMI I NDIKIMEVE NEGATIVE NE MJEDIS

Lloji i ndikimeve të identifikuara (direkte dhe jo direkte)

Ky vleresim kryhet ne baze te ligjit Nr. 10440, date 07.07.2011 “Per vleresimin e Ndikimit ne Mjedis” dhe kerkesave te VKM Nr. 686, date 29.07.2015 “Per vleresimin e ndikimit ne mjedis” dhe ka si synim identifikimin, vleresimin dhe parandalimin e ndotjes se mjedisit, me qellim mbrojtjen e mjedisit. Me mbrojtje te mjedisit do te kuptojme mbrojtjen e mjedisit nga ndotja e demtimi. Kjo perben perparesi kombetare dhe eshte e detyrueshme per cdo banor te Republikës së Shqipërisë, për të gjitha organet shtetërore, si dhe për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në territorin e Republikës së Shqipërisë.

- **Mbetjet e ngurta**

Mbetjet e krijuara nga stafi i punojseve do te grumbullohen ne koshat e vendosur nga administratori ,per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.Persa i perket mbetjeve nga aktiviteti ato do te jene mbetje nga therrja pjeset te cilat nuk jane te konsumueshme te cilat do te menaxhohen nga shoqeria LEAL shpk me te cilen subjekti ka marveshje premtimi date 20.12.2012. e cila eshte ne fuqi deri ne lajmerimin 3 muaj perpara te subjektit nese kerkohet qe te priset si mardhenie. Mbetjet nga stallat ku mbahen kafshet per kohe te shkurter do te perdoren per pleh per te mbjellat e vet subjektit te cialt jane ne afersi te vendit te ushtrimit te aktivitetit.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret per sherbime higjiene-sanitare per stafin e punes i cili do te kaloj ne rrjetin e kanalizimeve te zones.Ndersa ujerat e gjeneruar nga larja e thertores do te trajtohen ne impiantin e vet subjektit.

- **Shkarkimet ne ajer**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kemi shkarkime ne ajer por do te kemi vetem aroma nga stallat ku do te mbahen kafshet deri ne mometin e therjes, per kete arsye satllat jane te pajisura me ventilator per largimin e aromave .

- **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e transportit te cilat do te bejne transportin e kafsheve si dhe te mishit ,keto zhurma jane brenda normave te lejuara per nje aktivitet te tille.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e administratorit jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e punes jane vendosur ne vende te dukshme fikset konform rregullave te sigurise.

4. MASAT PER ELEMENIMIN/ZVOGELIMIN E NDIKIMEVE

- **Territori perreth objektit**

I gjithe territori i objektit dhe rruga hyrese ne te eshte e shtruar dhe e sistemuar. Jane marre masa edhe per gjelberimin e territorit perreth aktivitetit duke bere te mundur mbjelljen me bimesi.

- **Mbetjet e ngurta**

Mbetjet e krijuara nga stafi i punojseve do te grumbullohen ne koshat e vendosur nga administratori ,per tu derguar me pas ne vendet e caktuara nga pushteti vendor.Persa i perket mbetjeve nga aktiviteti ato do te jene mbetje nga therrja pjeset te cilat nuk jane te konsumueshme te cilat do te menaxhohen nga shoqeria LEAL shpk me te cilen subjekti ka marveshje premtimi date 20.12.2012. e cila eshte ne fuqi deri ne lajmerimin 3 muaj perpara te subjektit nese kerkohet qe te priset si mardhenie. Mbetjet nga stallat ku mbahen kafshet per kohe te shkurter do te perdoren per pleh per te mbjellat e vet subjektit te cialt jane ne afersi te vendit te ushtrimit te aktivitetit.

- **Shkarkimet e ujerave**

Uji perdoret per sherbime higjieno-sanitare per stafin e punes i cili do te kaloj ne rrjetin e kanalizimeve te zones.Ndersa ujerat e gjeneruar nga larja e thertores do te trajtohen ne impiantin e vet subjektit.

- **Shkarkimet ne ajer**

Nga zhvillimi i ketij aktiviteti nuk kemi shkarkime ne ajer por do te kemi vetem aroma nga stallat ku do te mbahen kafshet deri ne mometin e therjes, per kete arsye satllat jane te pajisura me ventilator per largimin e aromave .

- **Zhurmat**

Zhurmat shkaktohen nga mjetet e transportit te cilat do te bejne transportin e kafsheve si dhe te mishit ,keto zhurma jane brenda normave te lejuara per nje aktivitet te tille.

- **Mbrojtja nga zjarri**

Nga ana e administratorit jane marre masat per mbrojtjen ne rast renie te zjarrit si dhe zbatimi i rregullave te sigurimit teknik. Ne ambientet e punes jane vendosur ne vende te dukshme fikset konform rregullave te sigurise.

- **Kushtet e punes**

Persa i perket sigurimit teknik te punonjesve,ky aktivitet nuk perdor lende te rrezikshme apo mjete te tilla te cilat te vene ne rrezik jeten e punojsve , linja teknologjike eshte e standarteve te fundit.

5. KONKLUZIONE

Konkluzione

- Ky aktivitet nuk perdor lende te demshme por mbetjet dhe ujrak qe gjenerohen nga larja e ambjenteve mund te demtojne rende mjedisin ne rast se shoqeria nuk do te merrte masa per menaxhimin e tyre.
- Higjena gjate proceseve te punes eshte maksimale dhe ushtrohen kontrole te vazhdueshme nga Instituti i Higjenes.
- Zbatohen ne menyre te perpikte rregullat sipas kerkesave higjeno sanitare dhe veterinare per mbajtjen dhe therjen e kafsheve.
- Ky aktivitet nuk ka ndikim negativ ne popullsi, nuk prek zona te mbrojtura, objekte te rendesise se vecante.
- Gjate aktivitetit nuk ka ndotje te tokes pasi subjekti ka marre masa per menaxhimin e mbetjeve nga aktiviteti duke lidhur kontrate me subjektin i cili do te merret me menaxhimin e tyre, ujerave duke i trajtuar ne impiantin qe ka instaluar dhe ajrit duke instaluar nje sistem ventilimi per largimin e aromave .
- Per nje siguri maksimale zbatohen, ne menyre te perpikte, rregullat e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes kunder zjarrit.
- Aktiviteti nuk ka efekte anesore ne mjedis dhe me masat e marra nuk ka premisa qe te sjelle ndotje mjedisit apo pasoja negative per shendetin e njerezve te flores dhe faunes.

Punoi: ” **Eko Studio projekt** ” shpk